

**LIGJ**  
**Nr. 6/2025**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8952, DATË 10.10.2002,**  
**“PËR LETËRNJOFTIMIN ELEKTRONIK TË SHTETASVE SHQIPTARË”,**  
**I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në titullin e ligjit pas fjalës “elektronik” shtohen fjalët “dhe digjital”.

**Neni 2**

Në nenin 1 pas fjalëve “letërnjoftim unik,” shtohen fjalët “elektronik ose digjital”.

**Neni 3**

Në nenin 2 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas fjalisë së parë të pikës 1 shtohen fjalitë me këtë përmbajtje:

“Letërnjoftimi mund të jetë në formë elektronike ose digjitale. Në çdo rast, shtetasit mund të zgjedhin për t’u pajisur me një nga format e letërnjoftimit ose mund të pajisen njëkohësisht me letërnjoftimin në të dyja format, elektronike dhe digjitale.”.

2. Në pikën 4 pas fjalës “Letërnjoftimi” shtohet fjala “elektronik”.

3. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Rregullat dhe procedurat për paraqitjen e kërkesës për pajisjen me letërnjoftimin elektronik e digjital, pajisja, si dhe dokumentet e nevojshme, që shoqërojnë kërkesën, përcaktohen me udhëzim të ministrit të Brendshëm.”.

**Neni 4**

Në paragrafët e parë dhe të dytë të nenit 4 fjala “elektronik” hiqet.

**Neni 5**

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 5**

Shtetasi pajiset me letërnjoftim të ri kur plotëson kushtet e nenit 3 të këtij ligji dhe kur:

- a) njëri nga përbërësit e gjendjes civile, të pasqyruar në letërnjoftim, ka ndryshuar, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi; ose
- b) vërtetohet nga organet përkatëse se letërnjoftimi i ka humbur ose i është vjedhur; ose
- c) është dëmtuar; ose

ç) në çdo rast tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi.”.

#### Neni 6

Në nenin 5/1 shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) vërtetohen rastet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji.”.

#### Neni 7

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Paragrafi i parë numërohet me numrin 1 dhe në paragrafin e parë pas fjalës “Letërnjoftimi” shtohet fjala “elektronik”.

2. Pas paragrafit të parë shtohen pikat 2 dhe 3 me këtë përmbajtje:

“2. Letërnjoftimi digjital është dokument identiteti në të cilin janë pasqyruar qartë dhe janë shënuar me metoda digjitale të gjitha elementet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Përveç elementeve të pikës 1 të këtij neni, në letërnjoftimin digjital përfshihen edhe:

a) çelësi kriptografik, që mundëson identifikimin digjital dhe certifikatën përkatëse;

b) informacioni, i cili mundëson nënshkrimin digjital, duke përfshirë një çelës kriptografik, që mundëson nënshkrimin digjital dhe certifikatën përkatëse;

c) të dhëna të tjera teknike, të nevojshme për funksionimin ose përdorimin e identitetit digjital.

3. Të dhënat e tjera teknike, që përfshihen në letërnjoftimin digjital sipas shkronjës “c” të pikës 2 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

#### Neni 8

Pas nenit 6 shtohet neni 6/1 me këtë përmbajtje:

##### “Neni 6/1

1. Shoqëria aksionare përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike është përgjegjëse për:

a) krijimin e letërnjoftimit digjital dhe të infrastrukturës teknike e teknologjike për garantimin e sigurisë dhe të besueshmërisë së letërnjoftimit digjital;

b) administrimin e bazës së të dhënave shtetërore për letërnjoftimin digjital;

c) krijimin e kushteve për kryerjen e transaksioneve digjitale ndërmjet palëve të treta edhe nëpërmjet përdorimit të letërnjoftimit digjital.

2. Shoqëria aksionare përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike mund t’i përmbushë përgjegjësitë e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni vetë ose nëpërmjet shoqërive të tjera, që kanë eksperiencën dhe kapacitetet teknike e financiare për krijimin e letërnjoftimeve digjitale, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të posaçëm në fuqi.”.

#### Neni 9

##### **Nxjerrja e akteve nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktin nënligjor të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri i Brendshëm që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktin nënligjor të parashikuar në nenin 3 të këtij ligji.

#### Neni 10

##### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 30.1.2025.

**Shpallur me dekretin nr. 42, datë 19.2.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.**